



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:285597

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05740946

KPPP.nr. 2193/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Eco Tek, me numër unik identifikues 811276311 dhe me seli në Gjakovë, rr. “Tefik Qanka”, nr. 22, kundër debitorit “Die Bau” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810045410 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Ibrahim Femi”, nr. 12, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 769/23 i datës 21.11.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi nga Gjakova, jashtë seancës me datën 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Die Bau” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 769/23 i datës 21.11.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Eco Tek, me datë 21.11.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 769/23, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 09/22, e datës 08.02.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, sipas faturës së lartcekur t’ia paguajë kreditorit shumën prej 8,300.00 EUR, me kamatë ligjore nga dita e lëshimit të faturës, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se kreditori ka përcaktuar vlerën e borxhit, mirëpo nuk ka bashkangjitur marrëveshjen nga e cila kanë rrjedhur të drejtat dhe detyrimet mes palëve kontraktuese. Më tej, ka theksuar se kreditori në propozimin për përbarim ka bashkangjitur një

faturë në lartësi prej 14,300.00 €, e që debitori ka paguar shumën prej 6,000.00 €, ndërsa pjesën tjetër e kërkon duke mos u bazuar në ndonjë marrëveshje për kryerjen e ndonjë pune juridike, e që do ta bënte të drejtë kërkesën e kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsyetim se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të faturës e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29, par. 3 të LPP-së, si dhe të njëjtën debitori e ka pranuar, duke qenë i njoftuar me detyrimin që rrjedh nga e njëjta. Ka shtuar se pretendimit i debitorit se nuk ka bashkangjitur kontratë apo marrëveshje, nga e cila do të kishin rrjedhur të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, është i pa bazuar pasi që debitori si blerës ka porositur sendin tek shitësi, këtu kreditori, e sipas porosisë është bërë edhe pranim dorëzimi i mallit, si dhe është pranuar fatura nga debitori. Duke qenë se tendenca e debitorit është shmangia nga detyrimi që ka ndaj kreditorit, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 09/22, e datës 08.02.2022., i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma

e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por erdhi në përfundim se të njëjtat nuk paraqesin asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2193/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.